



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Tiranë, më 16.3.2018

Nr. prot.  
5448/

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.590, datë 26.12.2000.

**SHOQËRISË "2D" SH.P.K**  
Miniera e Qymyrgurit, Qenskë, Korçë.

Për dëgjim: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE  
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM**  
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "2D" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.590, datë 26.12.2000, për mineral qymyrguri në minierën "Qenskë", Korçë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.5935, datë 01.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5448, datë 02.08.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.590, datë 26.12.2000, për mineral qymyrguri, në minierën "Qenskë", Korçë, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor për vitin 2016, por dhe për vitin 2017, përcaktuar sipas pikës 5 të nenit 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Lcja juaj është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në germën "ç", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.590, datë 26.12.2000, për mineral qymyrguri në minierën "Qenskë", Korçë, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.590, datë 26.12.2000, për mineral qymyrguri, në minierën "Qenskë", Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**  
**DAMIAN GJIKNURI**

**NË MUNGESË DHE ME POROSI**  
**ZËVENDËSMINISTRI**  
**ENIS ALIKO**

